

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime THOR INDUSTRIES SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë 3/kati 11, Shkup, Maqedonia e Veriut dhe PE-VLA-KU SHPK (PE-VLA-KU SHPK), me seli në Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga Muzaket, Palatet Vokshi, Hyrja 1, Kati. 7, Tiranë, Shqipëri, përmes avokatit Ivan Debarliev nga Shoqëria e Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Keleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 14.07.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin **Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime THOR INDUSTRIES SHPKNJP Shkup**, me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë 3/ kati 11, Shkup, Maqedonia e Veriut dhe **PE-VLA-KU SHPK** (PE-VLA-KU SHPK), me seli në Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga Muzaket, Palatet Vokshi, Hyrja 1, Kati. 7, Tiranë, Shqipëri do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi **Shoqërinë për ndërtim dhe shërbime SORAVIA INVEST SHPKNJP Shkup**, me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 Soravia/Qendër Shkup, Maqedonia e Veriut dhe mbi **Shoqërinë e ndërtimit dhe shërbimeve SORAVIA MANAXHMENT SHPKNJP Shkup** me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr.3, Shkup, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 09.06.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime THOR INDUSTRIES SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë 3/ kati 11, Shkup, Maqedonia e Veriut dhe PE-VLA-KU SHPK (PE-VLA-KU SHPK), me seli në Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga Muzaket, Palatet Vokshi, Hyrja 1, Kati. 7, Tiranë, Shqipëri, me

të cilën THOR INDUSTRIES SHPKNJ dhe PE-VLA-KU SHPK do të fitojnë kontroll të përbashkët Shoqërinë për ndërtim dhe shërbime SORAVIA INVEST SHPKNJ Shkup, me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3 Soravia/Qendër Shkup, Maqedonia e Veriut dhe mbi Shoqërinë e ndërtimit dhe shërbimeve SORAVIA MANAXHMENT SHPKNJ Shkup me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr.3, Shkup, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

THOR INDUSTRIES është një shoqëri e themeluar në vitin 2020, me veprimtari: zhvillimin e projekteve të ndërtimit.

THOR INDUSTRIES ka një filial në Maqedoninë e Veriut - THOR IT SISTEMS Shkup me seli në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. Kati 3/11 Shkup - Qendër e cila kryen punë konsulente kompjuterike.

Partner direkt i THOR INDUSTRIES është z. Drin Ahmedi i cili zotëron 100% të kapitalit themelor të kompanisë. Z. Ahmedi zotëron pjesë edhe në shoqëri të tjera të themeluara në Maqedoninë e Veriut edhe atë

- Shoqërinë për prodhim, tregti, ndërtim dhe shërbime EVEREST XHD SHPKNJ eksport-import Kërçovë Tane Caleski nr. 30-1/2, Kërçovë, me veprimtarinë e ndërtimit të objekteve tjera të inxhinierisë civile, që nuk përmenden diku tjetër dhe
- Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime POTAM-PLANT import-eksport DOOEL Kërçovë, Tane Caleski nr. 30-1/2, Kërçovë, me aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (shoqëria ende nuk është aktive)

PE-VLA-KU është një nga kompanitë më të mëdha të ndërtimit në Shqipëri dhe Kosovë, e themeluar në vitin 2005. PE-VLA-KU në ekzistencën e saj, e sidomos vitet e fundit, ka planifikuar dhe realizuar me sukses dhjetëra projekte ndërtimore. PE-VLA-KU ka bërë hapa të suksesshëm në ekonominë e tregut të lirë dhe me projektet e saj ka qenë pjesë e zhvillimit të të dy vendeve. Me një eksperiencë mbi 14 vjeçare, puna, veprimtaria dhe aktivitetet e tyre po zgjerohen dhe janë të pranishme në shumë zona të Shqipërisë dhe Kosovës.

Në Maqedoninë e Veriut, PE-VLA-KU ka një prani përmes filialit të saj PE-VLA-KU Tiranë, Shqipëri – Filial në Republikën e Maqedonisë së Veriut Shkup, me seli në ul. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 3-11/, Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitet të regjistruar: zhvillim të projekteve ndërtimore.

SORAVIA INVEST SHPKNJ Shkup është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 2006, me veprimtari të regjistruar: lëshimi dhe administrimi i pasurive të paluajtshme të veta ose pasuri të paluajtshme të marra me qira (Lizing). SORAVIA INVEST SHPKNJ Shkup është pronar i Qendrës së Biznesit Soravia e cila gjendet në Shkup në rr. Filipi i Tretë i Maqedonisë nr.3, Shkup - Qendër.

SORAVIA MANAXHMENT SHPKNJ Shkup është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 2006, me aktivitet të regjistruar: menaxhimin e pasurive të paluajtshme me honorar ose në bazë të kontratës dhe vepron si ofrues shërbimi për menaxhimin e Qendrës së Biznesit Soravia.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски